



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



RR E G U L L O R E
PËR
VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË
PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

Prishtinë, qershor 2014

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, nenit 14, paragrafi 14.1 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja a e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 24.06.2014, miratoi këtë

RR E G U L L O R E
PËR
VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË
PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen: llojet e objekteve të përkohshme (në tekstin në vazhdim *objekti i përkohshëm*), kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimi dhe largimi i objekteve në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes.

Neni 2.

Vendosja dhe ndërtimi i objekteve të përkohshme sipas kësaj rregulloreje, nënkupton të gjitha punët e ndërtimit që janë të nevojshme për vendosjen/ndërtimin e bazës për vendosjen e objekteve të tilla.

Neni 3.

Objektet e karakterit të përkohshëm mund të vendosen dhe ndërtohen në pronën publike, me kusht që të mos pengojnë funksionimin e institucioneve, bizneseve që veprimtarinë e ushtrojnë në objekte të karakterit të përhershëm, nuk rrezikojnë ambientin jetësor (zhurma, largimi i mbetjeve të mbeturinave etj.).

II. LLOJET E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME

Neni 4.

1. Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a) lokalet e përkohshme, lokal për kryerjen e shërbimeve ekonomike, i cili nuk mund të ketë sipërfaqe më të madhe se 30 m² dhe lartësi nga 2.5 m deri në 3.5 m dhe i cili nuk mund të vendoset para objektit afarist;
- b) qoshqet, dyqan i vogël, i vendosur në bazën e betonit, i punuar nga materiali i lehtë, me sipërfaqe e cila nuk mund të jetë më e madhe se 15 m² dhe lartësi deri në 2.20 m, ku shiten gazeta ose çikërrima të ndryshme.
- c) antenat satelitore dhe transmetuese, objekte që vendosen me qëllim të emetimit të valëve të mjeteve të teknologjisë informatike.

- d) kabinat telefonike, hapësirë e vogël e ndarë prej xhami ose metali, që shërben për ofrimin e shërbimit telefonik.
- e) ekranet elektronike reklamuese, pllakë prej lënde të posaçme (prej xhami, argjendi etj.) të lidhura me aparate të ndryshme, ku me anë të dritës riprodhohen figura, sinjale etj dhe
- f) strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve, strehë e vendosur, ku njerëzit mbrohen nga të reshurat dhe dielli gjatë kohës së pritjes së autobusëve lokalë dhe ndërurbanë.
- g) panot dhe tabelat reklamuese, tabelë - hapësirë, e paraparë për reklamime të ndryshme të shoqërive biznesore.

2. Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen edhe:

- a) tavolinat para lokaleve gjatë sezonit veror, objekt i punuar nga materiali i lehtë (druri, metali, plastika), që mund të ketë sipërfaqe deri në 2 m² dhe shërben për shitjen e mallit në funksion të objektit afarist.
- b) tavolinat gjatë sezonit veror/dimëror, me rrethojë nga xhami, nga kuota 0.00 të jetë ha=1.7m, hapësirë që gjendet para objektit hotelier, me pjesë të mobiluara (tavolina, karrige, çadra dhe të ngjashme), e dedikuar për ofrimin e shërbimeve në funksion të objektit hotelier.
- c) tavolinat lëvizëse për shitjen e librave, kartolinave, panoramave, fotografive artistike, bizhuterive, luleve etj, objekt lëvizës, të punuar nga materiali i lehtë (druri, metali ose plastika), që mund të ketë sipërfaqe deri në 2 m² dhe shërben për shitjen e librave, kartolinave, panoramave, fotografive, bizhuterive etj.
- d) pajisjet për shitjen e akulloreve, pofkave, misrit, gështenjave dhe të ngjashme, aparat për përgatitjen e produkteve ushqimore, i cili së bashku me shtëpizën e aparatit, nuk kalon sipërfaqen prej 2 m².
- e) automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë, automjet i veçantë, i atestuar për kryerjen e veprimtarisë për shitjen e ushqimit të shpejtë.
- f) tendat e hapura lëvizëse, me mekanizëm dhe me elemente montuese nga materiali pleksiglas, konstruksion, i cili vendoset mbi vitrinën reklamuese në fasadë të ndërtesës, me konstruksion të ngjitur.
- g) lojërat sezonale në parqe, grumbullim i elementeve konstruktive të mjeteve - aparateve, të cilat vendosen në një hapësirë në pronën publike të dedikuar për karakter zbavitës.
- h) rrethojat e përkohshme, deri në 60 cm lartësi, elemente që vendosen nga ana e rrugës për mbrojtjen e hapësirave gjelbëruese. Mënyra e ndërtimit, forma, materiali dhe ngjyra e rrethojave, duhet të harmonizohet me ambientin përreth, por lartësia e tyre nuk mund të jetë mbi 60 cm.
- i) panairët dhe promocionet që zgjasin deri në tri (3) ditë, ekspozitë me produkte të ndryshme të shoqërive biznesore, ku mund të lidhen edhe marrëveshje e të bëhen porosi, i cili mund të zgjasë deri në 3 ditë.
- j) shkallët para lokaleve, ekzistuese dhe montuese, në bazë të lejes së dhënë nga DUNMM-ja;
- k) gjeneratorët statikë;
- l) aparatet klimatike dhe oxhakët e lokaleve;
- m) pajisjet elektronike, të teknologjisë informatike, telefonike etj.);
- n) gërmimi, shtrirja e rrjetit kabllor dhe shfrytëzimi i tubave nëntokësor për vendosjen e rrjetit kabllor (elektrik, internet, telefonik).

III. PLANI I VENDOSJES SË OBJEKTEVE TË PËRKOSSHME

Neni 5.

1. Objektet e karakterit të përkohshëm, të cekura në nenin 4, paragrafi 1, pikat a - g të kësaj rregulloreje, vendosen dhe ndërtohen në lokacionin e paraparë me planin e vendosjes së objekteve të karakterit të përkohshëm (në tekstin në vazhdim *Plani*).
2. Plani miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Kuvendi i Komunës.
3. Plani i cekur në paragrafin 2, përmban:

- a) Pjesën tekstuale: përmban kushtet kryesore teknike – urbane të vendosjes së objekteve në pikëpamje të: llojit, sipërfaqes dhe pamjes së objektit të përkohshëm, si dhe zonat dhe afatin e dhënies së tyre.
- b) Pjesën grafike: paraqet caktimin detal për secilin lokacion, kushtet urbane – teknike që ka të bëjë me zonat ku do të vendosen objektet e përkohshme.

Neni 6.

1. Propozimi për hartimin e planit është në kompetencë të organit kompetent të Komunës për çështje të planifikimit, urbanizmit dhe ndërtimit.
2. Në raste të caktuara, disa punë për hartimin e planit mund t'u besohen personave fizikë dhe juridikë, në procedurën dhe mënyrën e paraparë me Ligjin e prokurimit publik në fuqi, e në bazë të detyrave projektuese që i cakton organi i cekur në paragrafin 1.
3. Gjatë hartimit të Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme, pos tjerash, duhet respektuar edhe këto kritere:

- a) që të vendosen në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes dhe administrimit;
- b) që me vendosjen e përkohshme të objekteve, nuk do të krijohen pengesa në lëvizjen e lirë në trotuare dhe hapësira të tjera;
- c) që në udhëkryqe dhe kënde të rrugëve, të mos zvogëlohet dukshmëria dhe të mos rrezikohet siguria në komunikacion;
- d) që të mos dëmtohet vlera mjedisore dhe kulturo - historike;
- e) që objekti i vendosur të bëhet sipas tërësisë së kompleksit arkitektonik;
- f) që vendosja e objektit të bëhet në distancë nga rrugët e kategorizuara, të parapara me Ligjin në fuqi për rrugët;
- g) që objekti i vendosur të mos pengojë shfrytëzimin normal të objekteve të përhershme.

IV. KUSHTET DHE PROCEDURAT E VENDOSJES, NDËRTIMIT DHE LARGIMIT TË OBJEKTEVE TË PËRKOSSHME

Neni 7.

1. Objektet e karakterit të përkohshëm vendosen dhe ndërtohen në bazë të lejes për vendosjen/ndërtimin e objektit të përkohshëm.

2. Lejen nga paragrafi 1 i këtij neni, për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.1, pikat a - g, e jep organi kompetent për punët e urbanizmit dhe ndërtimit, kurse për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.2, pikat a - n, e jep organi kompetent për shërbime publike.

3. Lejimi i vendosjes/ndërtimit bëhet me vendim, i cili përmban: shënimet e shfrytëzuesit, lokacionin, llojin dhe destinimin e objektit të përkohshëm, sipërfaqen, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, obligimet e shfrytëzuesit lidhur me rregullimin e hapësirës dhe kyçjen në infrastrukturë komunale.

Neni 8.

Kërkesës për leje të vendosjes/ndërtimit i bashkëngjiten:

1. Për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.1, pikat **a-g**:

a) Për lokale të përkohshme:

- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit,
- pjesa grafike e lokacionit,
- zgjidhja ideore,
- vërtetimi i pagesës së taksës për shfrytëzim dhe
- dokumenti i identifikimit.

b) Për qoshqe:

- kontrata për shfrytëzim e lokacionit,
- pjesa grafike e lokacionit,
- zgjidhja ideore,
- vërtetimi i pagesës së taksës për shfrytëzim dhe
- dokumenti i identifikimit.

c) Për vendosjen e antenave satelitore dhe shpërndarëse:

- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit,
- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- pjesa grafike e lokacionit,
- zgjidhja ideore,
- vërtetimi i pagesës së taksës për shfrytëzim dhe
- dokumenti i identifikimit.

d) Për kabinat telefonike:

- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit;
- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- projekti i lokacionit me skicë dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

e) Për ekranet elektronike reklamuese

- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit;
- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- projekti i lokacionit me skicë,
- atesti teknik dhe elektronik,
- statika dhe pesha e ekranit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

f) Për strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve:

- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit,
- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- projekti i lokacionit me skicë dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

g) Për panot dhe tabelat reklamuese:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit,
- atesti i qëndrueshmërisë (statika, tokëzimi) dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

2. Për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.2, pikat a - n:

a) Për tavolinat para lokaleve gjatë sezonit veror:

- projekti me dimensionet e hapësirës,
- certifikata e biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

b) Për tavolinat gjatë sezonit veror/dimëror, me rrethojë nga xhami nga kuota 0.00 të jetë ha=1.7m:

- projekti me dimensionet e hapësirës,
- certifikata e biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

c) Për pajisjet për shitjen e akulloreve, pofkave, misrit, gështenjave dhe të ngjashme:

- projekti me dimensionet e hapësirës,
- certifikata e biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

d) Për tavolinat lëvizëse për shitjen e librave, kartolinave, panoramave, fotografive artistike, bizhuterive, luleve etj.:

- projekti me dimensionet e hapësirës,
- certifikata e biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

e) Për automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- certifikata e kualifikimit përkatës për ushtrimin e biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

i) Për tentat e hapura lëvizëse, me mekanizëm dhe me elemente montuese nga materiali pleksiglas:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

j) Për lojërat zbavitëse në parqe:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

k) Për rrethojat e përkohshme, deri në 60 cm lartësi:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

l) Për panaiet dhe promocionet, deri në tri (3) ditë:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

m) Për shkallët para lokaleve, ekzistuese – montuese, në bazë të lejes së dhënë nga DUNMM-ja:

- leja e dhënë nga DUNMM – ja,
- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

n) Për gjeneratorët statikë:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- specifikat e gjeneratorit (lloji),
- atesti për mbrojtje nga rreziqet, të lëshuar nga DSHMSH - ja,
- atesti për mbrojtje nga zhurma,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

o) Për aparatet klimatike dhe oxhakët e lokaleve:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

p) Për pajisjet elektronike, të teknologjisë informatike, telefonike etj.:

- certifikata e regjistrimit të biznesit,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

q) Për gjurmimin, shtrirjen e rrjetit kabllor dhe shfrytëzimin e tubave nëntokësor për vendosjen e rrjetit kabllor (internet, elektrik, telefonik etj.):

- licenca për veprimtarinë përkatëse;
- plani i situacionit me dokumentacionin teknik dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.

Neni 9.

1. Vendimi për lejimin e vendosjes/ndërtimit të objektit, lëshohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e ushtrimit të kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet me plan dhe këtë rregullore.
2. Leja pushon të vlejë, nëse objekti nuk vendoset/ndërtohet në afatin e caktuar në vendim.
3. Anulimi i lejes sipas kësaj rregulloreje, bëhet me vendim të veçantë. Vendimin për anulimin e lejes e merr organi i cili e ka lëshuar lejen.
4. Në vendimin nga paragrafi 3 i këtij neni, caktohet afati për largimin e objektit. Afati nga paragrafi 3 i këtij neni, është 8 ditë nga dita e pranimit të vendimit mbi anulimin e lejes.
5. Nëse objekti nuk largohet brenda afatit të caktuar sipas vendimit për largimin e objektit të përkohshëm, largimin e objektit e bën organi kompetent për inspektim, me detyrim që shpenzimet për largimin e objektit t'i mbulojë poseduesi i lejes për vendosjen e objektit.
6. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit për largimin e objektit të përkohshëm.

Neni 10.

Leja për vendosjen/ndërtimin e objektit të përkohshëm në pronën publike, lëshohet më së largu deri në përfundimin e vitit kalendarik.

Neni 11.

1. Shfrytëzuesi i objektit të karakterit të përkohshëm, është i obliguar që ta largojë objektin e karakterit të përkohshëm në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e kalimit të afatit të caktuar në vendim, pa të drejtë kompensimi dhe pa të drejtë sigurimi të një lokacioni për vendosjen e ndonjë objekti tjetër.
2. Nëse shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm nuk vepron në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, largimi i objektit do të bëhet në mënyrë të dhunshme, me shpenzime të shfrytëzuesit. Me rastin e largimit të dhunshëm, Inspekcioni komunal dhe ekzekutuesi, nuk mbajnë përgjegjësi për dëmtimin eventual të objektit, mjeteve dhe mallit që gjendet në objekt.

V. DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS PUBLIKE NË UDHËHEQJE DHE ADMINISTRIM TË KOMUNËS

Neni 12.

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës publike bëhet në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe planin e vendosjes së objekteve të përkohshme për një kohë të caktuar.
2. Koha e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nënkupton përfundimin e viti kalendarik, me mundësi që afati të zgjatet edhe për vitin tjetër, në rast se shfrytëzuesi në mënyrë të rregullt i ka përfunduar obligimet e vitit paraprak.
3. Leja për vendosjen e objektit të përkohshëm mund të tërhiqet para kalimit të afatit të caktuar, nëse:
 - a) paraqitet nevoja për realizimin e planit urbanistik, të programit të rregullimit, apo për shkak të pengimit të trafikut të këmbësorëve;
 - b) ka kaluar afati i caktuar për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike;
 - c) nuk kryhet pagesa për shfrytëzimin e tokës ndërtimore brenda afateve të caktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
 - d) objekti tjetërsohet te personi i tretë, në bazë të faljes, shitjes, ndërrimit apo dhënies me qira.

Neni 13.

Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme miratohet për një periudhë (5) pesëvjeçare.

Neni 14.

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës publike për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 1, pikat a - g, bëhet përmes ankandit publik, kurse për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 2, pikat a - n, bëhet me dhënien e drejtpërdrejtë nga organi kompetent për administrim të sipërfaqeve publike.
2. Kontratën për shfrytëzimin e pronës publike për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 1, pikat a - g, e nënshkruan shfrytëzuesi i pronës publike, kurse në emër të Komunës, Kryetari i Komunës.

Neni 15.

Objekti i përkohshëm është i përshtatshëm për përdorim, nëse:

- a) mund të përdoret për destinimin e paraparë;
- b) nuk rrezikon jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- c) nuk rrezikon dhe nuk pengon shfrytëzimin e objekteve në afërsi;
- d) janë plotësuar kushtet për sigurim nga zjarri, mos pengim të trafikut, si dhe kushtet për mbrojtje në punë;
- e) objekti është ndërtuar sipas kushteve të parapara, në bazë të të cilit është dhënë leja;
- f) janë plotësuar kushtet e veçanta, të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 16.

Pranimin teknik e bën Komisioni për pranim teknik të objekteve pranë DUNMM – së, sipas kërkesës së investuesit. Për pranimin teknik hartohet procesverbali. Në procesverbal shënohet lënda e pranimit teknik, dokumentacioni i cili i është ofruar komisionit, mendimi dhe propozimi i komisionit. Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit.

Neni 17.

1. Organi i Administratës i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, ka për detyrë ta japë lejen për përdorim brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së mendimit nga komisioni se objekti është i përshtatshëm për përdorim.
2. Organi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të refuzojë dhënien e lejes për përdorim, nëse investuesi nuk i ka plotësuar kushtet që janë përcaktuar në lejen për vendosje/ndërtim.

Neni 18.

1. Nëse gjatë shikimit teknik vërtetohet se lëshimet në objektin e vendosur/ndërtuar nuk mund të mënjanojnë dhe për shkak të atyre lëshimeve ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, organi që e ka dhënë lejen për ndërtim merr vendimin për rrënimin e objektit, përkatësisht largimin e objektit.
2. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk ndalon zbatimin e vendimit.

VI. MBIKËQYRJA

Neni 19.

1. Mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj rregulloreje e bën organi kompetent për administrimin e pronës publike.
2. Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e kësaj rregulloreje, i kryen Inspekcioni komunal i organit kompetent për punët e inspektimit.

Neni 20.

1. Shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm është i obliguar që të mirëmbajë objektin dhe hapësirën përreth objektit.
2. Nëse shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm nuk e mirëmban objektin dhe hapësirën përreth objektit, Inspekcioni komunal, me vendim të veçantë, urdhëron shfrytëzuesin e objektit për eliminimin e të metave të konstatuara.

Neni 21.

Organi kompetent për inspektim, me vendim, urdhëron heqjen (largimin, demolimin) e objektit pa kompensim (në shpenzimet e pronarit të objektit), nëse:

- a) vepron në kundërshtim me nenin 7;
- b) vepron në kundërshtim me nenin 15;
- c) vepron në kundërshtim me nenin 20;

VII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 22.

Personi fizik dhe personi juridik, do të gjobitet nga Inspekcioni komunal i Drejtorisë së Inspekcioni me gjobë prej 450 € deri 750 €, nëse:

- a) vepron në kundërshtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje;
- b) vepron në kundërshtim me nenin 15 të kësaj rregulloreje; dhe
- c) vepron në kundërshtim me nenin 20 të kësaj rregulloreje.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË HYRJES NË FUQI

Neni 23.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfrytëzuesit e objekteve të përkohshme mbajnë të drejtën e shfrytëzimit deri në ditën e kalimit të afatit të caktuar në vendim.

Neni 24.

Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës, në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 25.

Për çdo çështje që nuk është rregulluar me dispozitat e kësaj rregulloreje, zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë dhënien e pronave publike në shfrytëzim.

Neni 26.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen rregulloret dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës për vendosjen e objekteve në sipërfaqe publike.

Neni 27.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e dorëzimit të saj në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

KUVEDNI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110 - 157481, më 01.07.2014

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.